



Rrjeti i Grave të Kosovës

Mbështet, mbron dhe promovon të drejtat dhe interesat e grave dhe vajzave në Kosovë

8 nëntor 2022

Të nderuar anëtarë të Kuvendit,

Rrjeti i Grave të Kosovës (RrGK) po ju shkruan për të shprehur shqetësimet tona në lidhje me projektligjin aktual për Parandalimin dhe Mbrojtjen nga Dhuna në Familje, Dhuna ndaj Grave dhe Dhuna me Bazë Gjinore. Konsiderojmë që ky është një ligj thelbësor dhe urgjentisht i nevojshëm për mirëqenien e grave dhe vajzave në Kosovë, prandaj, i njëjti duhet të shqyrtohet me kujdes deri sa të jetë në përputhje me Konventën e Stambollit, e gjithashtu edhe me Kushtetutën e Republikës së Kosovës.

Pas shqyrtimit të kujdesshëm ndaj projektligjit dhe bazuar në ekspertizën tonë të gjerë në fushën e zbatimit të kornizës ligjore, në lidhje me dhunën me bazë gjinore, shqetësimet tona kryesore në raport me këtë projektligj janë si në vijim:

1. Ligji duhet të fokusohet në mbrojtjen dhe rehabilitimin nga "dhuna me bazë gjinore", e cila duhet të përkufizohet së pari në fillim të ligjit, dhe të përfshijë të gjitha format e tjera të dhunës me bazë gjinore (p.sh. dhunën në familje, dhunën seksuale dhe dhunën ndaj grave). Kjo, për arsye se të gjitha format e dhunës të listuara aktualisht në projektligj, janë forma të dhunës me bazë gjinore, dhe mund të përfshihen nën këtë emërtim, si tërësi. Përveç kësaj, dhuna me bazë gjinore prek edhe djemtë e ndonjëherë edhe burrat, kështu që të drejtat e tyre gjithashtu duhet të mbrohen përmes këtij ligji, duke theksuar ndërkohë që gratë janë të prekura në mënyrë disproporcionale nga dhuna për shkak të marrëdhënieve historike të socializuara të pushtetit midis grave dhe burrave. Pasi të përkufizohet dhuna me bazë gjinore, ajo mund të përdoret njejtë përgjatë, me një terminologji të qëndrueshme për t'iu referuar të gjitha formave të dhunës; kjo do të thjeshtonte gjuhën e ligjit, e cila aktualisht është hutuese dhe shpesh kundërthënëse. Ligji duhet gjithashtu të kontrollohet për përdorim të vazhdueshëm të terminologjisë së njejtë ligjore dhe përkufizimeve zyrtare në të gjitha gjuhët. Për shembull, është shqetësues fakti që projektligji aktual shpesh i referohet vetëm dhunës në familje, ndërkohë që shërbimet e përshkruara në ligj duhet të jenë të disponueshme për të gjitha format e dhunës me bazë gjinore, përfshirë dhunën seksuale, sipas Konventës së Stambollit. Kështu, ne propozojmë përdorimin e termit "dhunë me bazë gjinore" si një term gjithëpërfshirës, përgjatë tërë ligjit.

2. Ligji duhet të përcaktojë më qartë përgjegjësitë e institucioneve specifike. Sipas Konventës së Stambollit, organi që monitoron zbatimin e ligjit duhet të jetë i ndarë nga organi që zbaton ligjin. Ne rekomandojmë që Koordinatorin/ja Nacional kundër Dhunës me Bazë Gjinore (i/e cili/a nuk adreson vetëm dhunën në familje por edhe format e tjera të dhunës me bazë gjinore) së bashku me Grupin Koordinues Ndërmënysh kundër Dhunës me Bazë Gjinore të udhëhequr nga Koordinatorin/ja të ketë përgjegjësinë e monitorimit dhe raportimit në nivel kombëtar. Pastaj, institucionet përgjegjëse për zbatimin e ligjit, siç janë: Policia, QPS-të, Mbrojtësit e Viktimave, të kujdesen për aspektin e zbatimit të këtij ligji. Në këtë aspekt, përgjegjësitë e secilës prej institucioneve individuale për monitorimin dhe vlerësimin e performancës e akterëve zbatues (p.sh., Inspektorati policor, Prokuroria, Departamenti për Punë dhe Mirëqenie Sociale, dhe tjerë sipas nevojës) duhet poashtu të bëhen të qarta dhe të renditen në mënyrë specifike në kuadër të ligjit.

Në nivel komunal, ne rekomandojmë që të funksionalizohen dy lloje të Mekanizmave Koordinues lokal, përsëri, në favor të ndarjes korrekte të përgjegjësisë të zbatimit dhe monitorimit të zbatimit të këtij ligji, në pajtim me Konventën e Stambollit.

- Si Mekanizëm të parë koordinues, ne propozojmë krijimin e Mekanizmit Koordinues Lokal të Politikave, i cili duhet të përbëhet nga zyrtarë përgjegjës komunalë nga institucionet përkatëse komunale (psh. Drejtoria e Buxhetit dhe Financave, Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, mes tjerave). Mekanizmi Koordinues Lokal i Politikave duhet të jetë përgjegjës për pjesën e politikë-bërjes, buxhetimit, monitorimit dhe vlerësimit të punës së institucioneve dhe akterëve përgjegjës në nivel lokal (Saktësisht, propozimi ynë i artikuluar në Nenin 25 të Projektligjit). Ky mekanizëm do ishte poashtu përgjegjës për hartimin e politikave lokale, në pajtim me Strategjinë Kombëtare për Mbrojtje nga Dhuna në Familje dhe Dhuna ndaj Grave. Rekomandojmë që ky mekanizëm me rol politikë-bërës, të koordinohet nga zyrtari/ja për barazi gjinore në kuadër të komunës, një pozitë publike, në bashkëpunim të plotë me kryetarin e komunës.
- Mekanizmi i dytë Koordinues Lokal për Menaxhim të Rasteve, duhet të përbëhet nga nënpunës publikë të certifikuar, si dhe profesionistë të fushës (shërbimeve sociale), të cilët bashkëpunojnë në asistimin e rasteve individuale, duke përfshirë këtu punëtorët social që ofrojnë shërbime sociale, mbrojtësit e viktimave, zyrtarët policorë nga Njësi i dhunës në baza gjinore, punëtorët shëndetësorë, strehimoret, dhe të gjithë këta akterë të cilët janë të specializuar në dhënien e shërbimeve (Për propozimin tonë konkret, referojuni propozimit në Nenin 26). Një punëtor social mund të shërbejë si Koordinator për Adresimin e Dhunës në Bazë Gjinore dhe të kujdeset për koordinimin e punës së Mekanizmit Koordinues Lokal për Menaxhim të Rasteve të dhunës me bazë gjinore. Këto të fundit mund të përfshihen në përkrahimin formal të vendit të punës, i cili duhet të krijohet për një person të tillë. Mekanizmi Koordinues Lokal për Menaxhimin e Rasteve duhet të fokusohet në krijimin e planit të punës dhe zbatimit të planeve menaxhuese të punës / rasteve nga ana e ushtruesve apo dhënësve të shërbimeve sociale.

Këto dy propozime janë plotësisht në harmoni me kërkesat e Konventës së Stambollit, për të ndarë përgjegjësitë e zbatimit prej përgjegjësisë të monitorimit dhe vlerësimit. Njëherit, përderisa ne rekomandojmë që Zyrtarët për Barazi Gjinore të koordinojnë Mekanizmin Koordinues Lokal për Politika, ne nuk mendojmë që të njëjtit duhet të koordinojnë edhe Mekanizmin Lokal për Menaxhimin e Rasteve pasi që Zyrtarët për Barazi Gjinore nuk janë të certifikuar për dhënien e shërbimeve sociale e as për menaxhim të rasteve. Në vend të kësaj, ZBGJ-të duhet të fokusohen në politikat në lidhje me barazinë gjinore dhe zbatimin e tyre në nivel lokal, dhe aspekte tjera të LBGJ-së. Njëherit, zyrtarëve lokal komunalë nuk duhet t'u lejohet qasja në raste individuale dhe menaxhim të rasteve, pasi që këta të fundit nuk janë të kualifikuar në dhënien e shërbimeve, dhe qasja në informata të rasteve mund të çojë konfidencialitetin e rasteve, që është tejet i nevojshëm për mbrojtjen adekuate të tyre.

Propozimet tona për diferencimin e këtyre dy mekanizmave koordinues lokalë, në pajtim me Konventën e Stambollit, janë të paraqitura në Projektligj, përkatësisht në Nenin 25 dhe 26.

3. Ne rekomandojmë që personat përgjegjës për menaxhimin e rasteve dhe personat përgjegjës për koordinimin e Mekanizmave Koordinues Komunalë për Menaxhim të Rasteve të jenë të kualifikuar, të specializuar dhe të certifikuar (në trajnime të dhunës me bazë gjinore), si zyrtarë

të shërbimeve sociale nga Qendrat për Punë Sociale. Kjo për shkak se ata kanë rolin dhe përgjegjësitë për menaxhimin e rasteve, duke përfshirë të drejtat e fëmijëve, të cilët shpesh preken në rastet e dhunës në familje dhe seksuale. Ne rekomandojmë që ky ligj të përcaktojë që çdo komunë do të ketë një numër të saktë të zyrtarëve të shërbimit social (bazuar në madhësinë e popullsisë, si p.sh. një zyrtar i shërbimit social për një numër të caktuar të rasteve, ku rastet bazohen në numrin e shtretërve të strehimoreve të rekomanduara në Konventën e Stambollit). Këta zyrtarë të shërbimit social duhet të jenë të çertifikuar dhe të specializuar vetëm në trajtimin e rasteve të dhunës me bazë gjinore. Kështu, ky ligj do të vendoste bazën për ndarjen e më shumë burimeve financiare për punësimin dhe çertifikimin e këtyre pozitave.

Ne tashmë kemi punuar me Ministrinë e Financave, Pagave dhe Transfereve – Departamenti i Politikave Sociale dhe Familjes, për hartimin e kurrikulave përkatëse, të cilat do të përshtaten në bazë të këtij ligji. Një zyrtar i shërbimeve sociale duhet të shërbejë si koordinator lokal për trajtimin e dhunës me bazë gjinore dhe të koordinojë menaxhimin e rasteve lokale si dhe Mekanizmin Koordinues si pjesë e përgjegjësive dhe përkrahimit të punës së zyrtarit. Në këtë mënyrë, koordinimi nuk do t'i nënshtrohet ndryshimeve që mund të ndodhin nga politikat lokale, pasi do të jetë një pozicion nëpunësi civil i mbajtur nga persona të kualifikuar. Mekanizmi koordinues lokal i cili koordinon menaxhimin e rasteve duhet të fokusohet në hartimin dhe zbatimin e planeve të menaxhimit të rasteve nga punëtorët socialë të cilët punojnë me rastet.

4. Nëse Koordinator/i ja Nacional kundër Dhunës në Familje mbetet në Ministrinë e Drejtësisë, përgjegjësitë për të siguruar qasje në shërbimet sociale (përveç qasjes në drejtësi), veçanërisht rehabilitimin dhe riintegrimin duhet të jenë shumë të qarta, pasi këto kanë qenë një mangësi e vazhdueshme në Kosovë. Këto nuk janë në kuadër të përgjegjësive të kësaj ministrie, kështu që puna me ministrinë e tjera dhe Grupin Koordinues Ndërmintor kundër Dhunës në Familje për këto çështje do të jetë thelbësore. Duhet theksuar brenda ligjit, se ABGJ do të shërbejë si organ koordinues në mungesë të Qeverisë, në mënyrë që të mos lihet pozita e paplotësuar dhe dhuna e pa adresuar mes ndryshimeve qeveritare dhe politike, siç ka ndodhur në të kaluarën.

5. Duke pasur parasysh ekspertizën tonë të gjerë si një rrjet i larmishëm prej 190 organizatash dhe përvojën tonë më shumë se 15 vjeçare në monitorimin dhe mbështetjen e adresimit të dhunës me bazë gjinore në Kosovë dhe në rajonin e Ballkanit Perëndimor, ne kërkojmë që të përfshihemi si anëtarë të përhershëm në Grupin Koordinues Ndërmintor kundër Dhunës në Familje, në të cilin besojmë se mund të vazhdojmë të kontribuojmë thellësisht.

6. Sipas Konventës së Stambollit, Kosova duhet të krijojë një linjë SOS 24-orëshe dhe falas. Përveç këshillave ligjore dhe referimeve, linja e ndihmës duhet të ofrojë edhe shërbime këshillimi psikologjik nga profesionistë të trajnuar. Duhet të sqarohet në ligj se kush do të financojë linjën 24-orëshe, dhe nëse linja e ndihmës do të jetë në përgjegjësi të Mbrojtësit të Viktimave, shërbimeve shëndetësore, OSHC-ve të kualifikuara ose ndonjë aktor tjetër, duke përcaktuar poashtu se çfarë kualifikime duhet të kenë personat përgjegjës për ofrimin e shërbimeve në kuadër të linjës. Të gjitha këto përgjegjësi duhet të bëhen të qarta në ligj dhe të ndahet një buxhet i caktuar për zbatimin e tyre.

7. Disa aktivitete të tilla si trajnimet dhe shërbimet në dispozicion të viktimave përmenden si përgjegjësi të një institucioni të vetëm specifik, në një nen përkatës për atë institucion, si dhe në një listë të përgjithshme të shërbimeve të disponueshme. Rekomandojmë që këto aktivitete të harmonizohen për të siguruar që të specifikohet secili institucion përgjegjës për secilin prej shërbimeve të listuara. Nëse këto përgjegjësi janë nën një nen specifik për atë institucion, ato mund të referohen përgjatë dokumentit në listën e shërbimeve të disponueshme. Ne kemi

sugjeruar që këto shërbime të përfshihen në Planin e Menaxhimit të Rastit, dhe ndoshta ato tani mund të hiqen nga seksionet e tjera përveçse në institucionin përkatës përgjegjës për të reduktuar përsëritjen.

8. Neni aktual 24, paragrafi 5, i cili rregullon financimin e strehimoreve nga rasti i asistuar është problematik sepse strehimoret duhet të jenë të hapura pavarësisht nëse kanë apo jo raste, dhe ato duhet të kenë gjithmonë staf në dispozicion për të ndihmuar rastet. Strehimoret nuk mund të mbyllen apo të largojnë stafin nga puna kur nuk kanë raste, pasi që nëse ka nevojë për trajtim të rasteve emergjente, strehimoret dhe stafi nuk do të jenë në dispozicion. Në vend të kësaj, ne rekomandojmë llogaritjen e shumës për strehimore bazuar në koston e funksionimit të tyre, e cila duhet të llogaritet në mënyrë transparente bazuar në një buxhet që përfshin të gjitha kostot përkatëse për të mbajtur të hapur strehimoren, me opsionin e financimit shtesë për kostot e shtuara që ato mund të kenë sipas nevojës, kur këto nevoja dokumentohen dhe arsyetohen mjaftueshëm. Ne kemi propozuar riformulim të Nenit përkatës edhe në lidhje me këtë.


9. Projektligji aktual nuk i referohet asgjëkundi Qendrave për Trajtimin e Krizave për Rastet e Dhunimit ose Qendrave të Referimit të Dhunës Seksuale, të cilat kërkohen nga Konventa e Stambollit dhe të cilat Kosova ende nuk i ka funksionalizuar. Ne rekomandojmë që të shtohen paragrafe përkatëse në ligj, të cilat rregullojnë saktësisht funksionet, rolet dhe përgjegjësitë, e poashtu edhe aspektin e financimit të Qendrave për Trajtimin e Krizave për rastet e Dhunimit dhe Qendrave të Referimit të Dhunës seksuale, në harmoni me kërkesat e Konventës së Stambollit. Mënyra e artikulimit të këtyre paragrafeve duhet të konsultohet paraprakisht edhe me Institutin e Mjekësisë Ligjore, i cili ka përvojë të mjaftueshme dhe i cili aktualisht po e udhëheqë edhe hartimin e Protokollit Shtetëror për Trajtimin e Rasteve të Dhunës seksuale, në bashkëpunim të përafërt me Ministrinë e Drejtësisë dhe RrGK, dhe me institucionet tjera relevante.

10. Në përgjithësi, rendi i kapitujve dhe nenet duhet të organizohen më qartë dhe më logjikisht për të specifikuar fillimisht palët përgjegjëse dhe më pas për të detajuar përgjegjësitë e tyre. Në projektligjin aktual, kapitujt dhe nenet janë të përziera e madje edhe përsëriten, duke nënkuptuar një paqartësi interpretimi.

Ju lutem gjeni bashkëngjitur rekomandimet tona specifike, të cilat i kemi përgatitur në një kohë tejet të limituar. E vlerësojmë nëse drejt finalizimit të këtij projektligji, ndahet më shumë kohë për të rishikuar me kujdes gjuhën e përdorur, por edhe aspektin e harmonizimit të plotë me Konventën e Stambollit.

Duke pasur parasysh se ne kemi një përvojë më shumë se 20 vjeçare të specializuar në trajtimin e dhunës me bazë gjinore, ne mirëpresim vazhdimin e diskutimit dhe bashkëpunimit me ju drejt finalizimit të këtij ligji. Ne gjithashtu shprehim gatishmërinë tonë për të prezantuar ndryshimet e propozuara edhe në kuadër të një prezantimi në komisionin parlamentar, nëse është e nevojshme, përmes të cilit mund t'i shpjegojmë më tej rekomandimet tona dhe të mbështesim komisionin drejt hartimit të një ligji në favor të sigurimit të mirëqenies, veçanërisht të grave dhe vajzave në Kosovë.

Sinqerisht,


Igballe Rogova
Drejtoare Ekzekutive
Rrjeti i Grave të Kosovës

